



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280-390-112

SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	E Drejta Diplomatike dhe Konsullore
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	O
Viti i studimeve/Semestri:	IV
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Dr. Urtak Hamiti
Asistent	
Detajet kontaktuese:	urtak.hamiti@uni-gjilan.net
Përshkrimi i lëndës	Kjo lëndë ka për qëllim të ofrojë një kuptim të teorisë dhe praktikës së rregullave ligjore të kodifikuara dhe zakonore që qeverisin veprimtarinë e misionëve diplomatike, misionëve konsullore dhe misionëve të përhershme pranë organizatave ndërkombëtare, si dhe aspektet e ndërlidhura që e karakterizojnë veprimtarinë e shërbimeve të jashtme ose të organeve shtetërore të ngarkuara për marrëdhëniet me jashtë. Në një përshkrim më të detajuar, lënda do të studiojë aspektet që lidhen me krijimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve diplomatike, statusin e shefave të shteteve apo qeverive, Ministrave të Jashtëm dhe të përfaqësuesve diplomatikë, si dhe me statusin dhe funksionet e misionëve diplomatike, detyrat e misionëve diplomatike, dhe imunitetet e privilegjet e misionëve dhe personelit diplomatik, konsullor, të misionëve të posaçme dhe misionëve pranë organizatave dhe konferencave ndërkombëtare. Për të ofruar një perspektivë praktike, një numër rastesh gjyqësore dhe praktika përkatëse e shteteve do të analizohet dhe diskutohet në klasë.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimet e lëndës janë mbi të gjitha ato të ofrimit të studentëve me njohuri më të thella në fushën e së Drejtës Diplomatike dhe Konsullore – si një nga nën- disiplinat juridike të së Drejtës ndërkombëtare publike. Në mënyrë që studentët t'i përmirësojnë njohuritë e tyre teorike dhe për të zhvilluar aftësinë e tyre për të zgjidhur probleme konkrete praktike, kjo lëndë do të mundësojë përmbushjen e këtij qëllimi – duke analizuar dispozitat përkatëse të traktateve ndërkombëtare dhe jurisprudencën, sidomos praktikën gjyqësore të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit me sukses të kësaj lënde, studentët janë në gjendje: (1) Të kuptojnë dhe shpjegojnë parimet themelore të artit të të bërit diplomaci, përfshirë origjinat dhe zhvillimin historik të diplomacisë; (2) Të dallojnë format e veçanta të institucioneve që përfaqësojnë shtetet dhe organizatat ndërkombëtare në marrëdhëniet e tyre të ndërsjella; (3) Të kuptojnë procesin e krijimit, funksionimit dhe përfundimit të marrëdhënieve diplomatike; (4) Të identifikojnë dhe kuptojnë kushtet ligjore në bazë të të cilave përfaqësuesit diplomatikë dhe konsullorë jetojnë dhe punojnë në shtetin pranues; (5) Të zhvillojnë shkathtësi komunikimi, në të shkruar dhe përmes prezantimeve verbale.		
Kontributi në ngarkesën e studentit			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kollokfiume, Seminare	2	2	4
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	0,5	10	5
Ushtrime në teren			
Seminare/projekt propozimi për temën e masterit			
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			
Përgatitja përfundimtare për provim			
Koha e kaluar në vlerësim të projekt-propozimit për temë të masterit			
Projektet, prezantimet etj			
Totali			
Metodologjia e mësimdhënies:	Prezantimi i njohurive themelore teorike përmes ligjëratave, seminareve (analiza e jurisprudencës dhe shembuj të legjislacionit të brendshëm); detyra individuale.		
Metodat e vlerësimit:	Do të ketë një provim përfundimtar – pjesa kryesore e vlerësimit – që do të mbulojë materialet e detyrueshme për lexim, si shtesë		

	e asaj që është thënë në ligjërata. Nota do të varet në vlerën prej 60 për qind (%) nga ky provim. Për pjesën tjetër të vlerësimit (40 %), studentët do të kenë: 1) Një apo dy prezantime gojore dhe mbrojtjen e të njëjtave përpara studentëve, për jo më pak se 15 minuta. Prezantimi do të jetë lidhur me një çështje të trajtuar në këtë lëndë apo për një temë që do të përcaktohet në konsultim me profesorin e lëndës; 2) Shkrimi dhe he dorëzimi i një punimi për të njëjtën çështje (të prezantuar gojarisht), apo ndonjë çështje tjetër (e cilat përcaktohet në marrëveshje me profesorin). Për nga aspekti i formës, punimi duhet të ketë jo më pak se 7 dhe jo më shumë se 10 faqe të kompjuterit, double-spaced, formati 12 Times New Roman. 3) Një minimum prej 55 % është i nevojshëm për notë pozitive kaluese. Inkurajohet pjesëmarrja aktive, përmbajtësore dhe e rregullt e studentëve në ligjërata.
Literatura	
Literatura bazë:	Borut Bohte, Vasilka Sancin, <i>E Drejta Diplomatike dhe Konsullore</i> (Prishtinë, Kolegji Victory, 2011)
Literatura shtesë:	• Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike e vitit 1961; • Ligji për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës; • Ligji për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Kosovës; • Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës; • Ligji për Statusin, Imunitetet dhe Privilegjet e Misioneve Diplomatike, Konsullore dhe Personelin e Kosovës dhe Praninë Ndërkombëtare Ushtarake si dhe personelin e saj; • Ligji për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës; • Rregullorja për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës. • Zejnullah Gruda (2009), Manual Diplomatik. Prishtinë; • Çdo libër nga e Drejta Ndërkombëtare Publike, pjesa mbi të Drejtën Diplomatike dhe Konsullore; • Eileen Denza (2008), Diplomatic Law. A Commentary on the Vienna Convention on Diplomatic Relations, 3rd ed. Oxford: Oxford University Press; • Milan Jazbec (2008), Bazat e Diplomacisë. Prishtinë: Kolegji Universitar "Victory"; - Ludwik Dembinski (1998), The Modern Law of Diplomacy. External missions of states and international organizations. Dordrecht-Boston-Lancaster: Martinus Nijhoff Publishers; • S. Murty (1989), The International Law of Diplomacy. The Diplomatic Instrument and World Public Order. New Haven: New Haven Press, Dordrecht-Boston- London: Martinus Nijhoff Publishers; - Rene Albrecht - Carrie (1965), A Diplomatic History of Europe Since the Congress of Vienna. London: University Paperbacks
Plani i dizajnuar i mësim:	

Java	
Java	Ligjëratat që do të zhvillohet
Java e parë:	Përmbajtja, organizimi dhe kërkesat e lëndës; metodologjia e mësimdhënies dhe metoda e vlerësimit.
Java e dytë:	Nocioni i Diplomacisë -Organet e përfaqësimit të jashtëm të shtetit -Burimet e së drejtës diplomatike dhe konsullore -Kombet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian: kontributet për të Drejtës diplomatike dhe konsullore
Java e tretë:	Sfondi historik i zhvillimit të Marrëdhënieve Diplommatike dhe Konsullore -Misioni i përhershëm diplomatik -Zhvillimi i të drejtave mbi privilegjet dhe imunitetet diplomatike
Java e katërt:	Burimet Formale të së Drejtës Diplommatike dhe Konsullore - Konventa e Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplommatike (1961) -E Drejta Zakonore -E Drejta Nderkombetare Diplommatike Kontraktuese -Konventat Konsullore -Trashëgimi i Republikës së Kosovës në konventat ndërkombëtare mbi të drejtën diplomatike dhe konsullore nga RSFJ. -Burimet e brendshme juridike (te Kosoves) te se drejtes Diplommatike dhe Konsullore
Java e pestë:	E DREJTA DIPLOMATIKE -Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Diplommatike (KVMD) E Drejta e Misionit (<i>ius legationis</i>) -Vendosja e marrëdhënieve diplomatike dhe e misioneve të përhershme diplomatike - Funksionet e Misionit Diplommatik
Java e gjashtë:	Klasat dhe Rangu i Udhëheqësve të Misioneve Diplommatike -Kori Diplommatik Emërimi dhe Akreditimi -Përfundimi dhe ndërprerja e marrëdhënieve diplomatike Shuarja e misionit diplomatik
Java e shtatë:	Kollokfikum I
Java e tetë:	Privilegjet dhe Imunitetet Diplommatike – Imuniteti i Pronës -Konventa e Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplommatike (1961) - Paprekshmëria e hapësirave të misionit diplomatik, - Paprekshmëria e arkivave dhe dokumenteve të misionit, Liria e komunikimit dhe e korrespondencës diplomatike; Liria e lëvizjes -E Drejta e përdorimit të flamurit dhe e stemës së shtetit dërgues.
Java e nëntë:	Privilegjet dhe Imunitetet Diplommatike – Imuniteti Personal Imunitetet e përfaqësuesve diplomatike; Privilegjet e përfaqësuesve diplomatike; Përfitimi dhe Humbja e privilegjeve dhe imuniteteve diplomatike Personat që gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e plota diplomatike Personat që gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e kufizuara diplomatike.
Java e dhjetë:	Protokolli dhe Ceremoniali Diplommatik Preseansi

	Titujtë dhe menyra e të drejtuarit Takimet zyrtare Ceremonialet shtetërore Zia zyrtare Flamujt Dhuratat dhe suveniret Gjuha diplomatike Format e leterkëmbimit me shkrim Demonstratat
Java e njëmbëdhjetë:	Misionet speciale dhe Misionet e përhershme pranë Organizatave dhe Konferencave Ndërkombëtare Diplomacia multilaterale Emërimi i përfaqësuesve special Privilegjet dhe imunitetet e misioneve speciale dhe te anetareve te tyre Paprekshmëria personale Akreditimi dhe detyrat e misioneve të përhershme Imuniteti ndaj procedurave gjyqësore Heqja dorë nga imuniteti
Java e dymbëdhjetë:	E DREJTA KONSULLORE Hyrje, zhvillimi historik Vendosja dhe ndërprerja e marrëdhënieve konsullore Funksionet konsullore Llojet, klasat, dhe rangu i konsujve Procedura e emërimit Ndërprerja e funksionit të anëtarit të Konsullatës Privilegjet dhe imunitetet e përfaqësuesve konsullorë Konsujtë e nderit.
Java e trembëdhjetë:	Organizimi i Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës Emërimi i Ambasadorëve dhe Konsujve sipas legjislacionit te Republikës së Kosovës. Ligji për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës; Ligji për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Kosovës; Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës; Ligji për Statusin, Imunitetet dhe Privilegjet e Misioneve Diplomatike, Konsullore dhe Personelin e Kosovës dhe Praninë Ndërkombëtare Ushtarake si dhe personelin e saj; Ligji për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës; Rregullorja për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës.
Java e katërbëdhjetë:	Diplomacia Ekonomike Nocioni dhe Zanafilla Funksionet e diplomacisë ekonomike Diplomacia ekonomike në marrëdhëniet bilaterale Diplomacia ekonomike pranë organizatave ndërkombëtare.
Java e pesëmbëdhjetë:	Kollokfiium II
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
Politikat konform statutit të Universitetit “Kadri Zeka”	

